



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2022:029286

Datë: 10.05.2022

Numri i dokumentit: 02988948

P.nr.102/22

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit Veli Kryeziu, me zyrtaren ligjore Fikrije Rexhepi, në lëndën penale kundër të pandehurit N.H nga fshati Zh., Komuna e Gjilanit, për shkak të veprës penale, Vjedhja e Sherbimeve nga neni 314 paragrafi 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr.257/2022, të datës 14.02.2022, kërkesës për dhënien e urdhërit ndëshkimor PP.II.nr. 257/2022, të datës 08.03.2022, më datën 05.04.2022, mori këtë :

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan, për dhënien e urdhërit ndëshkimor ndaj të pandehurit : N.H nga fshati Zh., Komuna e Gjilanit, i lindur më 26.11.1968, në Gjilan, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

ËSHTË FAJTOR

Prej datës së pavërtetuar deri me datë 20.12.2021, në shtëpunë e tij në fshatin në Zh. i pandehuri në mënyrë të paautorizuar si shfrytëzues i energjisë elektrike, me qëllim që vetit t'i sjellë përfitim të kundërligjshëm pasuror, ka vjedhur energji elektrike, ashtu që njehsorin elektrik e ka të vendosur me komandë në majë të shtyllës të shkyçqur nga distanca, ku për shkak të borxhit është shkyçur nga rrjeti elektrik dhe pas kontrollit nga punëtorët e autorizuar të KEDS-it, është konstatuar se i njejtë është lidhur direkt në rrjetin elektrik, ku ka bërë harxhim të paautorizuar, dhe në këtë mënyrë të dëmtuarës KEDS-in, Distrikti në Gjilan, i ka shkaktuar dëm material në shumë prej 147.47 Euro.

-me çka ka kryer veprën penale Vjedhje e sherbimeve nga neni 314 paragrafi 6 e lidhur me paragrafin 1 të KPRK-s

Andaj, në bazë të dispozitës së lartë cekur ligjore dhe neneve 4, 38,69,70,71,72,81 dhe 82 të KPKK-së, si dhe neni365 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), të pandehurës i shqipton,

VËREJTJE GJYQËSORE

Ashtu që i pandehuri N.H i behet me dije se ka kryer veprë të dëmshme dhe të rezikshme, që përben veprë penale për të cilën nëse ai sërish kryen veprë të tillë, Gjykata do të shqiptoj sanksion më të rëndë penal.

Pala e dëmtuar, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontestin juridiko civil

Obligohet i pandehuri që të paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 20.00 (njetzet euro) në afat prej 15 ditësh pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, ka ngritur aktakuzën e lartcekur ndaj të N.H nga fshati Zh., Komuna e Gjilanit për shkak të veprës penale Vjedhje e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 të KPRK-s . Gjithashtu, Prokuroria Themelore në Gjilan, ka paraqitur kërkesë për dhënien e urdhërit ndëshkimorë, sipas të cilit të pandehurit ka kërkuar që t'i shqiptohet Vërejtje gjyqësore, pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor ngase janë plotësuar kushtet ligjore për një gjë të tillë.

Gjyqtari, pasi shikoi dhe analizoi aktakuzën, kërkesën për lëshimin e urdhërit ndëshkimor dhe gjitha shkresat e tjera të lëndës, konstatoi se duhet të pranohet kërkesa e Prokurorisë Themelore për dhënien e urdhërit ndëshkimorë ndaj të pandehurit N.H, dhe të pandehurit i shqiptoi dënimin me gjobë, ngase të dhënat e paraqitura në aktakuzë dhe provat e bashkangjitura, ofrojnë bazë të mjaftueshme për dhënien e urdhërit ndëshkimor.

Në bazë të deklaratës së të pandehurit, e përfaqësuesit të dëmtuarit, deklaratën e dëshmitarëve dhe foto dokumentacioni nga vendi i ngjarjes si dhe shkresave tjera të lëndës, gjyqtari konstatoi se i pandehuri N.H nga fshati Zh., Komuna e Gjilanit për shkak të veprës penale Vjedhje e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 të KPRK-s në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Duke u bazuar në këto që u ceken më lartë, gjykata e ka pranuar kërkesën e PTH dhe ndaj të pandehurit, pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor ka shqiptuar dënim me gjobë, ngase sipas bindjes së kësaj gjykate, dënimi me gjobë është i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë së tij, si dhe me caktimin e dënimit me gjobë do të mund të arrihet qëllimi i dënimit, nga neni 41 të KPRK.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, si dhe paushallin gjyqësor është marrë në bazë të nenit 451 paragrafi 1 të KPP, kurse, vendimi mbi kërkesën pasurore juridike, është marrë duke u bazuar në nenit 463 paragrafi 2 të KPP.

Nga të cekurat e më lartë dhe në bazë të nenit 495 të KPP, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.102/22, Më 05.04.2022

Zyrtarja Ligjore,
Fikrije Rexhepi

Gjyqtari,
Veli Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktgjykimi i pandehuri ose mbrojtësi i tij, mund të paraqesin kundërshtim në afat prej 8 (tetë) ditëve nga dita e pranimi të njëjtit.